




Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



**KOMUNA E PRISHTINËS**  
**KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

**V E N D I M**

- I. Miratohet vendimi për caktimin e grupit punues për ndërtesën e ish-Kinemasë së Armatës, sipas Marrëveshjes së Mirëkuptimit të dt.13.04.2018, e lidhur në mes të Komunës së Prishtinës dhe Ministrisë së Administratës Publike.
- II. Anëtarë të cekur në pikën I të këtij Vendimi janë:
  1. Alush Gashi, kryesues;
  2. Veton Nurkollari, anëtarë;
  3. Gerantina Kraja, anëtarë;
  4. Yll Rugova, anëtarë;
  5. Arif Muharremi, anëtarë.
- III. Anëtarët e grupit punues të cekur në pikën II të këtij vendimi caktohen me mandat një (1) vjeçar.
- IV. Detyrë e komisionit është krijimi i modalitetit të organizmit, zhvillimit dhe mirëmbajtjes së kinemasë, dhe gjithashtu gjatë mandatit të përcaktuar në nenin III do të përkujdeset që kinemaja të funksionojë si shtëpi e filmit dhe kulturës.
- V. Për kryerjen e detyrave komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

**I DORËZOHET:**

- Drejtorisë së Kulturës;
- Anëtarëve;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.



**KRYETARI I KOMUNËS**  
Shpend Ahmeti